



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 312, datë 06.06.2023

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}
TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË
NË GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA ME
VENDIMET NR. 499, NR. 500 DHE NR. 501, DATË 21.11.2022 TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR
KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 06.06.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të kandidatës, znj. {...} Tafa”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} Tafa, në procedurat e ngritjes në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.499, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

2. Me Vendimin nr. 500, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

3. Me Vendimin nr. 501, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

4. Në këto procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 21.11.2022, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 05.12.2022.

5. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionet e lirë të shpallur me vendimet si më sipër, ka kandiduar gjyqtarja znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

6. Me Vendimin nr. 66, datë 09.02.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë: 10. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi.

7. Më datë 10.02.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Më datë 23.02.2023, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse si dhe Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, sipas pikës 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, meqenëse verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidatë do të kryhet nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, bazuar në nenin 6 dhe nenin 57 pika 11 të Ligjit të ligjit 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

11. Për këtë kandidatë, është kërkuar informacion pranë strukturës së posaçme të Këshillit, në lidhje me verifikimet e kryera në zbatim të Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, meqenëse në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kandidatja ka qenë gjyqtare dhe i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Ky verifikim është në vijim e sipër si dhe do të përcillet për kompetencë Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, duke qenë se verifikimi i figurës për pozicionet në gjykatën e posaçme, për këtë kandidatë, është objekt i veprimtarisë së tyre.

12. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d” të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën*

pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronjat “b”, “c” “ç”, dhe “d” të pikës 5, të këtyre vendimeve, përcaktohet se: “b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; ç) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi: d) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

13. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për kandidaten znj. {...}, u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

13.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr.1732/3 prot., datë 09.03.2023, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

13.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale/drejtësinë kriminale, referuar gjykatave ku kandidata ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (stazhi profesional) dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, informacioni iu kërkua këtyre gjykatave. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjell elektronikisht, datë 07.04.2023, siç do të përshkruhet më poshtë; nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës informacioni i kërkuar është përcjell me Shkresën nr. 1223 prot., datë 20.03.2023, nga siç do të përshkruhet më poshtë.

14. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit paraparak në lidhje me kriteret formale të kandidimit për kandidaten {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 500 dhe nr. 503 datë

21.11.2022, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 31.05.2023, relatori e parashtroi çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

15. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 31.05.2023 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për verifikimin e plotësimit ose jo nga kandidatja në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR KRITERET E KANDIDIMIT

16. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

17. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: *“Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

18. Për verifikimin e kandidate në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale (referuar sa më sipër), duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

19. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës

në vitin 2014, ndërkohë që ai është emëruar si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (gjatë periudhës së stazhit profesional) për periudhën tetor 2013 deri në vitin 2015, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme. Në vijim ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ku vijon të ushtrojë funksionin dhe aktualisht.

20. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 12.07.2010 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

Me dekret nr. 8353, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekret nr. 9235, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

21. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

22. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kandidaten znj. {...}, rezulton si vijon:

Janar 2013 - Dhjetor 2013	Proces	Përfunduar
Civile Themeli	98	68
Urdhra ekzekutimi	0	163
Kërkesa civile	4	19
Këkesa penale	0	2
Gjithsej	102	252

23. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për kandidaten rezulton se:

Gjyqtarja {...} që nga emërimi në këtë gjykatë ka qenë e angazhuar si gjyqtare e seksionit penalgjy, gjyqtare e hetimit paraprak, gjithashtu edhe gjyqtare e seksionit civil. (Me urdhrin nr.30 prot, datë 25.04.2016 është gjyqtare e Dhomës Penale; me vendimin datë 21.05.2021 në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës janë bashkuar seksionet)

24. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

25. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

26. “Dhënia e pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” si kriter për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, 500 dhe 501 datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 47, pika 3, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili në fakt është një dispozitë referuese e cila referon konkretisht në nenin 48, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, që përcakton se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen. 2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet... ”.

27. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar , kandidatja ka depozituar:

- Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidatja, znj. {...}, i datës 05.12.2022, siedhe nga bashkëshorti z. Andi {...};

28. Sa sipër, Këshilli vlerëson se, rezulton se kandidatja, dhe familjarët e saj të afërt, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

29. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

30. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

31. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*

32. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

33. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

34. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

35. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “d”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ato parashikohen në pikën 3, shkronja

“a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

36. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit *“Për situatën e papajtueshmërisë ambientale”* datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

37. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

38. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

III. KONKLUZIONE

39. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të kriterëve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

40. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e

tjera ligjore në procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501 datë 21.11.2022.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 4 të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në shkronjën “a” të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 47, në pikën 7 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022; “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i tij, z. Klodian Kurushi,

V E N D O S I:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR